

2023-08-09

Lapsa të falsifikuara Ozempic® dhe Saxenda®

I nderuar Distributor,

Novo Nordisk është vënë në dijeni për disa lapsa Ozempic® dhe Saxenda® në Republikën e Kosovës që janë falsifikuar dhe nuk janë produkte legjitime. Produktet e falsifikuara janë shitur si brenda zinxhirit të ligjshëm të furnizimit me barna, ashtu edhe në atë të paligjshëm. Përmbajtja e lapsave të falsifikuar është krejtësisht e ndryshme nga produktet origjinale dhe nuk duhet të përdoret pasi që përbën rrezik për sigurinë e pacientit.

Lapsat origjinale Novo Nordisk Ozempic® dhe Saxenda® nuk zgjaten ose rriten në gjatësi kur vendoset doza. Rritja e shkallëzimit kryhet me doza fikse, si p.sh. .25 mg, .5 mg dhe 1.0 mg për Ozempic® dhe .6 mg, 1.2 mg, 1.8 mg për Saxenda®.

Për të mbrojtur sigurinë e pacientëve, Novo Nordisk po i informon distributorët, barnaret dhe spitalet në vendet e prekura, si dhe autoritetet lokale shëndetësore.

Çka duhet të bëni si distributor

- Duhet të jeni të vetëdijshëm për riskun e Ozempic® dhe Saxenda® të falsifikuar
- Kontaktoni Shërbimin ndaj Klientit të Novo Nordisk në Republikën e Kosovës nëse dyshoni se posedoni Ozempic® dhe/ose Saxenda® të falsifikuar.


Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim, ju lutemi kontaktoni Shërbimin ndaj Klientit të Novo Nordisk në Republikën e Kosovës.

Siguria e pacientëve është prioritet kryesor për Novo Nordisk dhe jemi në dialog të ngushtë me të gjitha palët e interesuara për t'i mbështetur pacientët në mënyrën më të mirë të mundshme nga produktet e falsifikuara.

Sinqerisht,

Mr.ph.Abdelnaser Çuni
Person i Kualifikuar për Farmakovigilencë

Informata shtesë



Shërbimi ndaj Klientit

**Novo Nordisk Pharma
Operations A/S Dega në Kosovë**

+383 38725681

koprsafety@novonordisk.com